



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.273/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Fahredin Ismajli komisioner nga subjekti politik PDK për shkak të kërcënimit gjatë ditës së votimit në komunën e Obiliqit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.273/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilën theksohet se me datën 11 qershor 2017 anëtarja e komisionit nga Lëvizja Vetëvendosje Elma Krasniqi në qendrën e votimit 1502e është kërcënuar prej komisionerit të subjektit politik PDK, Fahredin Ismajli. Sipas parashtruesit të ankesës kjo përbën shkelje të dispozitave të Kodit Penal si dhe të Rregullës 09/2013

Lidhur me rastin në fjale PZAP-i e njoftoi edhe Policinë e Kosovës dhe kërkoi nga ata që të ndërmarrin veprime konkrete.

Në raportin e policisë të datës 14.06.2017 të dorëzuar në PZAP theksohet se lidhur me rastin në fjale kanë marrë informata se në fshatin Mulloshëve në vendvotimin 1502E me datën 11.06.2017 ka ndodhur një kërcënim ndaj Elma Krasniqit komisionere nga LVV nga Fahredin Ismajli. Në lidhje me këtë rreshter Nuhi Kozmaqi ka kontaktuar personin përgjegjës të ankueses Anita Shabani përmes numrit të tel. dhe sipas saj ankuesja do të vij në stacionin Policor në Obiliq me datën 14.06.2017 prej orës 08:00, ku me datën 14.06.2017 në ora 13:35 në stacionin Policor në Obiliq ka ardhur Elma Krasniqi e lindur me 07.09.1997 në Plemetin e cila thotë se është zhvilluar një bisedë në mes Fahredin Ismajlit dhe vëzhguesve e komisionereve por se nuk ka

kurrfarë kërcënimi dhe se nuk është ndier e kërcënuar andaj nuk e sheh nuk e sheh te arsyeshëm te procedohet ras.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do ti vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Paneli konstatoi se ankesa është e pabazuar nga se siç shihet edhe nga raporti policor dhe nga deklarata e dhënë në Polici e Elma Krasniqit e cila pohon se nuk ka pasur kërcënim dhe se nuk është ndier e kërcënuar, si dhe as nga pala ankuese nuk është ofruar asnjë provë e cila do ti vërtetonte pretendimet e theksuara në ankesë, andaj në rast se pala ofron prova të reja në kuptim të nenit 118, paragrafi 4 të LPZ-së, PZAP do ta rishqyrton vendimin. Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 273/2017 më datën 14.06.2017



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.